



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 124, datë 28.10.2021

PËR

MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË VENDIMIT TË KËSHILLIT BASHKIAK NR.32, DATË 26.03.2021, PËRSA I PËRKET LISTËS SË PËRFITUESVE NGA PROGRAMI I PROCESIT TË RINDËRTIMIT PËR 4 BANESA KOLEKTIVE, LAGJA NR.17, RRUGA “LURA”, DURRËS TË DËMTUARA NGA FATKEQËSIA NATYRORE E TËRMETIT TË DATËS 26 NËNTOR 2019

Në zbatim të nenit 113, pika 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të Ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, Ligjit nr.45/2019 “Për mbrojtjen civile”, Ligjit nr.44/2015, “Kodi i Proçedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, Aktit Normativ nr.9, datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me Ligjin nr. 97/2019, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 750, datë 27.11.2019, “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës dhe Tiranë”, të ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.904, datë 24.12.2019 “Për përcaktimin e rregullave, të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe proçedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituese nga disa programe të proçesit të rindërtimit” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.5, datë 06.01.2020 “Për përcaktimin e rregullave dhe të proçedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projektet model” i ndryshuar, Urdhërit nr. 135, datë 01.03.2021 të zëvendëskryetarës së Bashkisë “Për ngritjen e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave të aplikantëve jofitues që nuk janë përzgjedhur nga programet e proçesit të rindërtimit me nivel dëmi DS4-DS5”, si dhe sipas relacionit të hartuar nga ky komision, me propozim të Zëvendëskryetarës së Bashkisë, e cila kryen funksionet e Kryetarit të Bashkisë,

KËSHILLI BASHKIAK
VENDOSI:

1. Miratimin e ndryshimit të Vendimit të Këshillit Bashkiak nr.32, datë 26.03.2021, përsa i përket listës së përfituesve nga programi i proçesit të rindërtimit për 4 banesa kolektive, lagja nr.17, rruga “Lura”, Durrës të dëmtuara nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26 nëntor 2019.
2. Miratimin e përfshirjes në Aneksin nr.1, pjesë përbërëse e Vendimit të Këshillit Bashkiak nr.32, datë 26.03.2021 të z. Enver Isufi, si përfitues në masën e strukturës së njësisë së banimit 2 + 1, nga programi i proçesit të rindërtimit të 4 banesave kolektive në lagjen nr.17, rruga “Lura”, Durrës, sipas relacionit hartuar nga Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, Bashkia Durrës.
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi, Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit, Komisioni i Posaçëm dhe Zyra e Posaçme e Rindërtimit, Rikonstruksionit dhe Rimëkëmbjes Ekonomike pranë Drejtorisë së Shërbimeve, Bashkia Durrës.

Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar).

KRYETARI KËSHILLIT BASHKIAK

Ani Dyrmishi



U shpall sot me datë 29.10.2021



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DURRËS
KOMISIONI I SHQYRTIMIT TË ANKESAVE

Nr. 3930/ prot.

Durrës, më 19.7.2021



RELACION

Në mbështetje të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, Aktit Normativ nr. 9, datë 16.12.2019, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, Ligjit nr. 22, datë 03.05.2018 “Për strehimin social”, VKM-së nr. 904, datë 24.12.2019 “Për përcaktimin e rregullave të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga disa programe të procesit të rindërtimit”, VKM-së nr. 5, datë 06.01.2020 “Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projektet model”, i ndryshuar, VKM-së nr. 329, datë 16.05.2021 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”, VKM-së nr. 750, datë 27.11.2019 “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës dhe Tiranë” si dhe Urdhërit nr. 135, datë 01.03.2021 të zëvendëskryetares së Bashkisë Durrës, Komisioni i Ankesave mori në shqyrtim ankesën e, Z. Enver Arif Isufi, banues në pallatin 998, lagjia nr. 17. Durrës.

Z. Enver Isufi me nr. ID F20217097K nuk është përfshirë në listën e përfituesve nëpërmjet Vendimit të Këshillit Bashkiak 32, datë. 26.03.2021.

Në vijim subjekti i është drejtuar Institucionit të Bashkisë Durrës nëpërmjet ankesës me nr. 3930 prot., datë 20.03.2021, duke kërkuar të përfshihet në listën e banorëve që përfitojnë hapësirë banimi në pallatin e ri i planifikuar për ndërtim, pas shembjes nga tërmeti të pallatit të mëparshëm. Ankesa u depozitua pranë Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave me datë 16.07.2021.

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave në shqyrtimin e ankesës vëren: Subjekti Enver Isufi ka aplikuar sipas, Aplikimit nr. 31 prot., datë 05.02.2020, ku kërkesa është regjistruar me nr. 6484 në regjistrin elektronik. Në dosjen e aplikantit janë këto dokumenta:

Formular aplikimi për të përfituar nga Programi i Rindërtimit.

Certifikatë për vërtetim pronësie, nr. Pas., 5/1000+1-2 ZK 8513 Vol: 66, Fq. 273, me sipërfaqe 56.67 m², aktualisht në pronësi të subjektit Enver Isufi, lëshuar me datë 01.09.2016, shoqëruar me Hartën treguese përkatëse.

Certifikatë për vërtetim pronësie, nr. Pas., 5/204+2-3 ZK 8513 Vol: 12, Fq. 21, me sipërfaqe 53.50 m², aktualisht në pronësi të subjektit Enver Isufi, lëshuar me datë 10.03.2005, shoqëruar me Hartën treguese përkatëse.

Certifikatë familjare në përbërje prej 4 personash e datës 05.02.2020.

Vërtetim nga Njësia Administrative nr.5, lëshuar me datë 05.03.2021, sipas së cilit vërtetohet që ankimuesi ka banuar në banesën e prishur përfshirë ditën e ndodhjes së fatkeqësisë natyrore.

Fotokopje e Kartës së Identitetit.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit vërehet se ankimuesi ka në pronësi një banesë që de fakto i përkasin dy certifikata pasurie. Sepse sipas kartelës shoqëruese është një shtesë në të njëjtin kat dhe hyrje me banesën ekzistuese. Pra jemi të mendimit që kjo banesë me dy certifikata të jetë e konsideruar si një e vetme kjo nga gjëndja faktike e situatës pavarësisht se ankimuesi nuk ka ribërë bashkimin në zyrat e ish Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Durrës. Në vijim duke trajtuar motivin se pse z. Isufi (ankimuesi) nuk është përfshirë në listat e përfituesve i referohemi mospërfshirjes nga Zyra e Posaçme e Rindërtimit, Rikonstruksionit dhe Rimëkëmbjes Ekonomike dhe Komisioni i Posaçëm për ekzistencën e një pronësie të dytë në emër të djalit të tij z. Alban Enver Isufi. Ky i fundit edhe pse në momentin e aplikimit është pjesë e certifikatës së gjëndjes familjare të ankimuesit është paralelisht pronar i një apartamenti, banesë sipas certifikatës së pronësisë nr. 1953584 datë. 17.07.2019 me sipërfaqe 63.37 m², me numër pasurie 5/651/ND+1-20, Volumi 56, faqe 108 në rrugën Dalip Peza, Lagja nr. 17 Durrës. Sipas dokumentacionit të administruar në dosje djali i ankimuesit, pra z. Alban Isufi gjithashtu është dëmtuar nga tërmeti i 26 nëntorit 2019 dhe apartamenti i tij është klasifikuar si banesë e dëmtuar në cilësinë e dëmit DS1. Djali i ankimuesit në momentin e mundësisë së përzgjedhjes së aplikimit për të përfituar nga rindërtimi ka zgjedhur të mos aplikojë duke respektuar ligjin dhe aktet nën ligjore që lidhen me aplikimin e njërit prej personave që janë pjesë e përbërjes familjare. Dhe në këtë aspekt është vërtetuar që ankimuesi pra babai i Albanit ka aplikuar edhe për masën e dëmit në funksion të programeve të rindërtimit dhe ka përfituar dhe shpërblim në masën DS3 sipas Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 70 datë 20.07.2020, në listë nbashkëlidhur me numër rendor 109 me numër aplikimi 6484. Pra Zyra e Posaçme e Rindërtimit, Rikonstruksionit dhe Rimëkëmbjes Ekonomike si edhe Komisioni i Posaçëm e kanë nxjerrë njëherë përfitues ankimuesin për një program rindërtimi, që do të thotë se ankimuesi i plotësonte më së miri

kushtet për të cilat është miratuar me Vendimin e Këshillit Bashkiak të cituar më sipër edhe pse "pengesa" e dy pronësisë ekzistonte edhe asokohe. Në vijim me Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 68, datë 15.07.2020 është përcaktuar vazhdimi i procedurave për prishjen e detyruar të apartamentit të ankimuesit i cili në vijim nuk u përfshi në listat fituese me arsyetimet e trajtuara më sipër.

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave nga verifikimi i dokumentacionit është i mendimit që pavarësisht përfitimit të grantit në masën DS3 ankimuesi duhet të ishte përfshirë në programin e rindërtimit sipas përfitimit referuar Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 32, datë. 26.03.2021 prej Zyrës së Posaçme të Rindërtimit, Rikonstruksionit dhe Rimëkëmbjes Ekonomike si edhe nga Komisioni i Posaçëm. Sepse ankimuesit nuk ja heq njëri të drejtën për të aplikuar për përfitim granti packa në vijim të procedurave është vendosur po nga Këshilli Bashkiak Durrës vazhdimi i procedurave për prishjen e detyruar dhe rindërtimin në të njëjtin truall. Të gjitha këto thjesht duhet të rregullohen nëpërmjet dorëzimit të grantit të përfituar dhe përfitimit të banesës kjo sipas pikës nr. 2 të nenit 21 të Aktin Normativ sipas së cilit:

përfitues të njësive të banimit në objektet e reja janë pronarët e njësive të banimit të objekteve të shembura.....struktura e njësisë së banimit që do ti kalohet përfituesve nuk duhet të jetë më e madhe se struktura e njësisë së banimit që përfituesi kishte në pronësi në objektin e shembur.

Duke dashur të sqarojmë situatën e ankimuesit i referohemi sërish Aktit Normativ në pikën 3 dhe 4 të nenit 5 ku citohet:

Në rast se të gjitha banesat në pronësi ose në posedim janë dëmtuar nga fatkeqësia natyrore, individi ose familja përfiton, sipas parashikimeve të këtij akti. vetëm për banesën që në datën e fatkeqësisë natyrore përdorej si vendbanim i zakonshëm..(referuar kësaj pike është e provuar nga vërtetimi i Njësisë Administrative që apartamenti i dëmtuar në pronësi të ankimuesit është vendbanimi i zakonshëm në ditën e ndodhjes së fatkeqësisë).

dhe

Individët dhe familjet, banesa e të cilëve është dëmtuar nga fatkeqësia natyrore, por që nga autoritetet përgjegjëse është vlerësuar si e banueshme. nëse nuk kanë përfituar nga ndonjë program tjetër i procesit të rindërtimit, përfitojnë kompensimin e dëmeve, sipas parashikimeve të këtij akti.

Pra, në rastin konkret ankimuesi Enver Isufi është listuar nëpërmjet Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 70 datë 20.07.2020, në listën me numër rendor 109 me numër aplikimi 6484 si subjekt përfitues për dhënie e ndihmës financiare në masën DS3. Por nuk është bërë në vijim ndryshimi i kategorizimit të dëmit edhe pse banesa e tij është prishur. Pra në këto kushte ankimuesi duhet të trajtohej prej Zyrës së Posaçme të Rindërtimit, Rikonstruksionit dhe

Rimëkëmbjes Ekonomike si edhe nga Komisioni i Posaçëm si person përfitues në bazë të gjëndjes së fundit të dëmit të shkaktuar gjithashtu duke parë edhe rastet e mëparshme të trajtuara nga Zyra e Posaçme e Rindërtimit, Rikonstruksionit dhe Rimëkëmbjes Ekonomike dhe Komisioni i Posaçëm.

Përsa i përket përfitimit nga programi rindërtimit DS3, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave i është drejtuar Zyrës së Posaçme të Rindërtimit, Rikonstruksionit dhe Rimëkëmbjes Ekonomike për të kuptuar nëse fondi ka kaluar drejt ankimuesit dhe përgjigja ka qenë negative. Pra ankimuesi pavarësisht që ka rezultuar përfitues për programin DS3, shumica e fondit të përcaktuar për këtë program nuk i është dërguar asnjëherë sepse nuk ka nënshkruar kontratën përkatëse duke qenë se pallati i tij u shemb.

Lidhur me këtë situatë jemi të mendimit që ankimuesi z. Enver Isufi duhet të jetë në listën e përfituesve sipas Vendimit të Këshillit Bashkiak 32, datë. 26.03.2021 duke u klasifikuar si përfitues referuar VKM-së nr. 904, datë 24.12.2019 “Për përcaktimin e rregullave të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga disa programe të procesit të rindërtimit”, vendim i cili klasifikon strukturën përfituese të banesës sipas pikës 20.1 dhe tabelës A sipas përbërjes familjare duke mbajtur në vëmendje edhe Aktin Normativ sipas së cilit neni 21 pika 2 cituar më sipër.

Duke trajtuar në vijim ekzistencën e përbërjes familjare në momentin e aplikimit që ka qenë prej 4 personash (në momentin e aplikimit) Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave i referohet kësaj përbërjeje familjare duke mos përfshirë djalin i cili ka në pronësi një banesë të dëmtuar dhe sipas dokumentave provohet që ka banuar në atë banesë që prej së bashku me familjen e tij të përbërë prej 2 vetash por që në certifikatë familjare në momentin e aplikimit të ankimuesit i përkiste përbërjes familjare të këtij të fundit. Pra Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave në trajtimin e rastit i referohet përbërjes familjare prej 3 vetash.

Sa më sipër propozohet që kjo praktikë ti kalohet Këshillit Bashkiak Durrës, i cili pas një trajtimi të rastit të gjykojë dhe vlerësojë mbi ndryshimin e Vendimit të Këshillit Bashkiak 32, datë. 26.03.2021 lidhur me përfshirjen e z. Enver Isufi në listën e përfituesve në masën e strukturës 2+1.


KOMISIONI I SHQYRTIMIT TË ANKESAVE



ARBEN ISAKU

ARDJAN ILJAZA

ERMAL LAMA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DURRËS

Nr. 868 / prot.
1

Durrës, më 04. 11. 2021



Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

KËSHILLIT BASHKIAK ✓
DURRËS

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.124 datë 28.10.2021 “Për miratimin e ndryshimit të vendimit VKB Nr 32 dt 26.03.2021, përsa i përket listës së përfituesve nga programi i procesit të rindërtimit për 4 banesa kolektive, Lagja Nr 17 Rruga Lura, Durrës të dëmtuar nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26.11.2019”

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI

ROLAND NASTO

